

Kështu, në datën **20.06.1998**, ai kishte dalë nga shtëpia, por kësaj radhe nuk u kthye më. Një apo dy ditë më vonë, Xhemajli dhe Ramizi kishin vendosur që ta braktisnin fshatin. Bashkëshorten e Xhemajlit dhe fëmijët i vendosën te xhaxhai Rexhepi, që jetonte afër Ferizit dhe Ramizit, kurse ata shkuan te një kushëri në fshatin e afërt. Në datën **24.06.1998**, Xhemajli vendosi që të kthehet në **Carrallevë/Crnoljevo**, për ta vizituar familjen. Me të ishte nisur Ramizi dhe kur u afruan shtëpisë së axhës Rexhep, i kishte vërejtur policia serbe dhe kishte shtënë në drejtim të tyre. Xhemajli u qëllua, kurse Ramizi arriti për të ikur. Pas lufte, Ramizi u kthye në fshat. Një vendas ia kishte treguar varret e Xhemajlit dhe Ferizit, në livadhet e familjes Çerkini. Ai kishte mësuar se trupi i Ferizit ishte gjetur në pyllin e afërt. Pas lufte, në vitin 2000, pjesëtarët e KFOR-it i kanë zhvarrosur trupat për t'i identifikuar. Familja kurrë nuk i mori mbetjet e tyre mortore.

**Burimet:** deklarata R.A, FDH-23584; deklarata R.A, FDH-36718.

### Vesel (Isak) Ahmeti

(1963, shqiptar nga Godanci i Epërm/Gornje Godance, komuna e Shtimes/Štimlje, punëtor, dy fëmijë)

Veseli gjatë viteve të nëntëdhjeta kishte punuar në Shkup [Maqedoni]. Në vitin 1997, u kthye në fshatin e lindjes. Ai jetonte me bashkëshorten Fatmiren, djemtë binjakë, babanë, dy vëllezër dhe familjet e tyre. Në datën **27.06.1998**, një orë pasmesnate, derisa të gjithë familjarët flinin, pranë shtëpisë së familjes Ahmeti në **Godancë/Epërm/Gornje Godance**, kishte ardhur një grup i maskuar i pjesëtarëve të UÇK-së. Veseli u hapi derën. E urdhëruan që të vishej dhe të nisej me ta. E dërguan në drejtim të panjohur. Familjarët nuk e kishin parë më kurrë. Komisioni i Qeverisë së Kosovës për Persona të Zhdukur në vitin 2009 i ka lajmëruar familjarët se një pjesë të mbetjeve mortore të Veselit [disa eshtra] janë gjetur në varrezat në lagjen *Dragodan*, në Prishtinë/Priština. Familjarët kishin vendosur që mos t'i marrin këto mbetje mortore, por të presin që të gjenden edhe

pjesët e tjera të mbetjeve mortore.

**Burimet:** deklarata A.I, FDH-36720; deklarata A.B, FDH-2763; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; ICTY, IT-03-66-T (F. Limaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 3.04.2008, FDH-29718; FHP, *Haski tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, XVIII, 74.

### Bora (Gradimir) Stefanović

(13.06.1970, serb nga Sokobanja, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Bora e kishte mbaruar Shkollën e Lartë për Punë të Brendshme në Beograd. Nga viti 1993, punoi në SHPB në Sokobanjë, kurse një vit më vonë është avancuar në pozitën e inspektorit. Nga janari i vitit 1998, Bora kishte shkuar katër here në Kosovë. Për herë të fundit shkoi më 18.07.1998. Në datën **25.07.1998**, gjendej në kolonën e automjeteve policore, e cila nga Prishtina/Priština shkonte në drejtim të Prizrenit/Prizren. Rreth orës 14:00, kalonin nëpër **Carrallevë/Crnoljevo**, kur kolona u sulmua me armë zjarri. Bora u qëllua me pushkë snajperi. Familjarët e varrosën atë më datën 26.07.1998 në Sokobanjë.

**Burimet:** deklarata V.S, FDH-21682; SMIP, *Teroristički...*, III, 935; KMKKRF, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 66.

### Selman (Sylë) Selmani

(1935, shqiptar nga Carraleva/Crnoljevo, komuna e Shtimes/Štimlje, bujk, pesë fëmijë)

### Agim (Selman) Selmani

(24.04.1965, shqiptar nga Carraleva/Crnoljevo, komuna e Shtimes/Štimlje, bujk, një fëmijë)

Në fund të qershorit të vitit 1998, rrethina e Carrallevës/Crnoljevo ishte e pasigurt, zhvilloheshin luftime në mes të forcave të UÇK-së dhe atyre serbe. Nëpër fshat kalonin shpeshherë forcat serbe, duke hapur zjarr ndaj shtëpive të banorëve. Gratë dhe fëmijët e familjes Selmani u zhvendosën në fshatin fqinj të Zborcit/Zborce. Në shtëpi kishin mbetur Selmani dhe djemtë e tij Izaimi dhe Agimi. Në mëngjesin e hershëm të datës **25.07.1998**, rreth orës 6:00, forcat serbe e kishin bombarduar fshatin. Me Selmanin, krahas djemve të